THIRRJE PUBLIKE

Për rekrutimin e një eksperti me kontratë shërbimi për mbështetjen e zbatimit të Planit të Integritetit dhe Planit të Barazisë Gjinore

Bashkia Sarandë shpall thirrjen publike për përzgjedhjen e një (1) eksperti individual, i cili do të angazhohet me kontratë shërbimi për të ofruar asistencë teknike dhe profesionale në mbështetje të zbatimit të:

Planit të Integritetit të Bashkisë;

Planit të Barazisë Gjinore të Bashkisë.

Eksperti do të angazhohet gjatë periudhës Gusht – Dhjetor 2026, me një angazhim prej 40 ditësh pune, sipas planit të punës dhe nevojave të institucionit.

Pozicion i hapura

1. Ekspert për Zbatimin e Planit të Integritetit dhe Planit të Barazisë Gjinore

Numri i ekspertëve: 1

Kriteret e përgjithshme

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

Të kenë diplomë universitare të nivelit Master ose ekuivalent në Shkenca Juridike, Administratë Publike, Shkenca Sociale, Shkenca Politike, Ekonomi, Sociologji, Politika Publike ose fusha të tjera të ngjashme.

Të kenë të paktën 5 vite eksperiencë profesionale në administratë publike, organizata kombëtare ose ndërkombëtare, institucione publike ose projekte zhvillimi.

Të kenë eksperiencë të dëshmuar në hartimin, zbatimin, monitorimin ose vlerësimin e politikave, strategjive ose planeve të veprimit.

Të kenë aftësi shumë të mira analitike, organizative dhe komunikuese.

Të kenë aftësi në hartimin e raporteve teknike dhe dokumenteve strategjike.

Të kenë njohuri shumë të mira të legjislacionit shqiptar dhe praktikave më të mira evropiane në fushën përkatëse.

Dokumentacioni i aplikimit

Kandidatët duhet të paraqesin:

Letër interesi;

Curriculum Vitae (CV) të përditësuar në format Europass ose ekuivalent;

Kopje të diplomës universitare;

Dokumente që vërtetojnë eksperiencën profesionale;

Referenca profesionale (nëse disponohen).

Afati i aplikimit

Dokumentet e aplikimit dorëzohen pranë Bashkisë Sarandë ose në adresën elektronike bashkiasarande@yahoo.com, jo më vonë se data 07/08/2026, ora 16:00.

Vetëm kandidati i përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen për fazat e mëtejshme të vlerësimit.

TERMAT E REFERENCËS (ToR)

Pozicioni: Ekspert për Zbatimin e Planit të Integritetit dhe Planin e Barazisë Gjinore

Qëllimi

Të mbështesë Bashkinë në zbatimin, monitorimin dhe raportimin e Planit të Integritetit dhe Planit të Barazisë Gjinore, duke kontribuar në forcimin e integritetit institucional, transparencës, llogaridhënies dhe parandalimit të korrupsionit, si dhe në zbatimin, integrimin e perspektivës gjinore në politikat dhe aktivitetet institucionale, si dhe monitorimin e rezultateve të planit.

Detyrat kryesore

Eksperti do të:

Mbështesë zbatimin e masave të parashikuara në Planin e Integritetit dhe Planin e Barazisë Gjinore.

Organizojë ose asistojë në zhvillimin e aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe trajnuese.

Ofron asistencë teknike për strukturat përgjegjëse.

Mbështesë integrimin e perspektivës gjinore në politikat dhe programet e bashkisë.

Mbështesë identifikimin dhe trajtimin e risqeve të integritetit.

Kontribuojë në përmirësimin e procedurave administrative që lidhen me integritetin institucional.

Organizojë ose asistojë në zhvillimin e sesioneve informuese dhe trajnuese për stafin.

Përgatisë raporte periodike dhe raportin përfundimtar të ekspertizës.

Kualifikimet

Diplomë Master në Drejtësi, Administratë Publike, Ekonomi, Shkenca Sociale, Sociologji, Shkenca Politike, Administratë Publike, ose fusha të ngjashme.

Minimumi 5 vite eksperiencë profesionale.

Eksperiencë në qeverisje të mirë, integritet institucional, transparencë, antikorrupsion ose administratë publike. Eksperiencë e provuar në barazinë gjinore, përfshirjen sociale, të drejtat e njeriut ose politika sociale.

Eksperiencë në hartimin ose monitorimin e planeve strategjike apo dokumenteve të politikave publike.

Njohuri shumë të mira mbi kuadrin ligjor shqiptar për integritetin dhe etikën në administratë. Njohuri shumë të mira të legjislacionit shqiptar dhe standardeve ndërkombëtare në fushën e barazisë gjinore.

Produktet e pritshme

Plan pune.

Instrumente monitorimi.

Raport përfundimtar mbi zbatimin e aktiviteteve.

Kohëzgjatja

Gusht – Dhjetor 2026.

Gjithsej 40 ditë pune.

Mënyra e vlerësimit

Kandidatët do të vlerësohen bazuar në:

Arsimin dhe kualifikimet profesionale – 20 pikë;

Eksperiencën profesionale të përgjithshme – 30 pikë;

Eksperiencën specifike në fushën përkatëse – 40 pikë;

Intervistën (nëse zhvillohet) – 10 pikë.

Bashkia rezervon të drejtën të zhvillojë intervista me kandidatët e listës së shkurtër dhe të kërkojë dokumentacion shtesë për verifikimin e informacionit të paraqitur.